



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:129499

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05488252

C.nr.257/22

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri me zyrtarin e lartë për bashkëpunim profesional Visar Morina, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D. K. nga fshati B. Komuna e Malishevës, të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve "SCLR Partners" Sh.P.K. me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Polica e Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë, rruga "Luan Haradinaj" nr.99, të cilën sipas ligjit e përfaqëson Avokatura Shtetërore-Avokati shtetëror Aida Aliu, me objekt kontesti: "Kompensimi i shujtave dhe pagës shtesë (pagës së trembëdhjetë)", vlera e kontestit **2,127.60 euro**, jashtë seancës gjyqësore me datë 22.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I. **APROVOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit D. K. nga Malisheva.
- II. **DETYROHET** e paditura Ministria e Punëve të Brendshme-Polica e Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë, që paditësit D. K. në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 531.90 €, e në total shumën prej **2,127.60 €** ($531.90 \times 4 = 2,127.60$ euro) me kamatë ligjore në lartësi prej 8 % në vit, e cila fillon të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë (28.04.2022) e deri në pagesën definitive.
- III. **REFUZOHET** si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë me të cilën paditësi ka kërkuar nga e paditura që në emër të kompensimit për ushqim (shujta), t'ia paguaj shumën 5 euro për një ditë pune, ose shumën prej 3,945.00 euro për 789 ditë pune.
- IV. **DETYROHET** e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 30.00 euro, në shumën e përgjithshme prej 134.00 euro në afat prej 7 ditëve, ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmarimit.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësi D. K. të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve "SCLR Partners" Sh.P.K. me seli në Prishtinë, në këtë gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurës Policia e Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar kompensimin e shujtave dhe pagës shtesë (pagës së trembëdhjetë), me arsyetimin se paditësi ka kontratë pune me kohë të pacaktuar me të paditurën në pozitën e zyrtarit policor nga data 21.09.2015 dhe gjatë kësaj kohe ka performancë të shkëlqyer, kështu që bazuar me dispozitën e nenit 29 par. 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 për marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, i takon kjo e drejtë.

Paditësi ka theksuar se ka parashtruar kërkesë te punëdhënësi për kompensimin e shujtave ditore dhe pagesën e një page mujore në fund të çdo viti kalendarik, mirëpo e paditura nuk është përgjigjur, dhe duke u ndodhur në këtë situatë, paditësi është detyruar të parashtoj padi për kompensimin e kërkesave të tij.

Nga arsyet e paraqitura në padi, paditësi ka kërkuar nga gjykata që të obligoj të paditurën që në emër të kompensimit të pagës së trembëdhjetë për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 t'ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 2,127.60 euro dhe në emër të kompensimit të shujtave ditore nga 5 euro për një ditë pune, respektivisht për 789 ditë, t'ia paguaj shumën prej 3,945.00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % nga dita kur kërkesat kanë arritur për përmbushje e deri në pagesën përfundimtare.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar në lartësinë që do të formohet deri në përfundimin e procedurës gjyqësore.

E paditura në përgjigjen e saj në padi të cilën e kemi pranuar me datë 29.02.2024, nuk e ka kontestuar faktin se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, por e ka kundërshtuar në tërësi padinë e paditësit si të pabazuar duke thënë se paga e 13-të nuk është realizuar për asnjë punonjës të policisë, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Ka shtuar se Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, përkatësisht Ligjin nr. 05/L-125, neni 20 par. 4 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë e kësaj, çdo nismë, duke përfshirë edhe nenin 29 pika 2 të UA nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare nuk është i obligueshëm, përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore - financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të. Sa i përket kamatës ligjore, ka konstatuar se paditësit nuk i është shkaktuar asnjë dëm, kurse performanca e punës, nuk parasheh detyrim se e paditura duhet ta shpërblej.

Më tej ka shtuar se Udhëzimi Administrativ i të paditurës ku është mbështetur kërkesëpadija e paditësve nuk ka veprim retroaktiv, si dhe nuk është në harmoni me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, dhe se Policia e Kosovës nuk mund të vendos për ndarjet buxhetore me anë të Udhëzimit Administrativ, por ato përcaktohen me anë të ligjit që i nënshtrohen miratimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Si i tillë, UA nr.02/2018 sa i përket implikimeve financiare nuk ka fuqi të prodhoj efekte financiare të cilat nuk janë paraparë me Ligjin mbi Ndarjen e Buxhetit, dhe mbi bazën e kësaj nuk mund të ketë përparësi një udhëzim administrativ ndaj ligjit.

Tutje ka theksuar se si pasojë e implikimeve buxhetore e paditura me dt. 29.09.2021 ka shfuqizuar UA nr. 02/2018, mbi marrëdhënien e punës në policinë e Kosovës, e që aktualisht është në fuqi UA nr. 01/2021 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës.

Gjithashtu e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit, ngase nuk ka bazë ligjore edhe sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme nr.213/2023 të datës 09.10.2023.

Për fund ka theksuar se e kundërshtojnë kërkesëpadinë e paditësit për pagën e 13-të sepse kjo vlen vetëm në bazë të mundësive financiare, që nënkupton se nuk është detyrim për të paditurën, andaj bazuar në të gjitha këto, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, të merr aktgjykim me të cilin do ta refuzoj në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit.

Provat dhe vlerësimi i tyre

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata ka konstatuar se në mes të palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimi i punësimit nr. ref. ... dhe kontrata e punës nr. ref. ... të cilat i janë bashkangjitur shkresave të lëndës.

Nga kërkesa me nr.2779 të datës 21.03.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka bërë kërkesë tek e paditura për pagesë të shujtave dhe pagës shtesë, por nuk ka marrë përgjigje.

Nga kontrata e punës vërtetohet se zyrtari policor D. K.ka kontratë pune me kohë të pacaktuar, kurse nga vërtetimi i punësimit i cekur më lart, gjykata konstatoi se paditësi e ka filluar punën te e paditura nga data 21.09.2015, dhe realizon pagë mujore në shumën prej 531.90 €.

Nga formularët e vlerësimit të performancës për vitet kalendarike 2018, 2019, 2020 dhe 2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka pasur vlerësim me notën 4 që korrespondon me vlerësimin plotësisht të kënaqshëm.

Vërtetimin, kontratën e punës si dhe formularët e lartcekur, gjykata i ka pranuar si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se: “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, andaj vërtetimit dhe kontratës me të cilin është konstatuar se paditësi është në marrëdhënie pune pranë të paditurës dhe formularëve me të cilin është bërë vlerësimi i punës së paditësit, gjykata ua fali besimin e plotë.

Baza ligjore dhe vlerësimi i gjykatës

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, që në këtë rast rezulton se padia e paditësve është pjesërisht e bazuar për arsye se:

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 të LPK-së, në të cilin përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”*.

Ndërsa për pjesën tjetër (refuzuese) të kërkesëpadisë, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 399 sipas të cilit: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Bazuar në faktet e çështjes, gjykata gjen se lidhur me kërkesën e aprovuar të paditësit për kompensimin e pagës së 13-të për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, i cili ka qenë në fuqi prej datës 14.11.2018 deri 29.09.2021 dhe bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.213/2023 të datës 09.10.2023 për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës.

Në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 përcaktohet se: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*, ndërsa me nenin 44 par.2 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë përcaktohet se: *“Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”*, kurse neni 55 par.1 nën par.1.7 i këtij Ligji përcakton se: *“Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”*.

Me nenin 29 paragrafi 2 të UA nr.02/2018 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*, kurse neni 30 paragrafi 2 të UA nr.01/2021 përcakton se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”*, ndërkaq bazuar edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.213/2023 të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë

për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës, në pikën -II- është paraparë se “*Në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021*”.

Nga interpretimi i dispozitave të lart cituara, të Udhëzimit Administrativ 02/2018 i cili është nxjerrë nga e paditura, Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit sa i përket shpërblimin për pagën e 13-të është e bazuar, sepse paditësi e gëzon të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik ta përfitoj si shpërblim një pagë mujore, e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësi i të paditurës, në këtë rast paditësi, të ketë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës dhe të mos i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës.

Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit të performancës që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se paditësi ka vlerësim të kënaqshëm të performancës dhe të njëjtit nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore gjatë viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Për më tepër e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje, me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditësit për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj paditësit.

Me rastin e vendosjes lidhur me detyrimin si në pikën II- të dispozitivit dhe lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021, gjykata mori për bazë vërtetimin e punësimit, të vlerësuar si më lart, nga i cili rezulton paga e paditësit, andaj të njëjtit për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 i takon shuma ashtu siç edhe është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, vlerëson se e paditura ka pasur për detyrim sipas dispozitave të lart cituara për ta kompensuar paditësin për pagat e 13-ta, për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, andaj paditësi e ka cilësinë e kreditorit, ndërsa e paditura cilësinë e debitorit kjo bazuar edhe me nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) në të cilin përcaktohet se: “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”. Së këndejmi gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitave të lartcekura dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shumën e gjykuar si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 par. 2 i LMD-së dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020,

duke filluar me llogaritjen e kamatës nga data 28.04.2022 si ditë e paraqitjes së kërkesëpadisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit.

Pjesa refuzuese

Gjykata e ka refuzuar në tërësi kërkesën e paditësit për kompensimin e shujtave ditore për gjithsej 789 ditë pune për periudhën kohore nga data nëntor 2018 e deri në muajin shkurt 2022, apo shumën prej 3,945.00 €, sepse me paragrafin 1 të nenit 29 të UA nr.02/2018 si dhe të nenit 30 paragrafi 1 të UA nr.01 /2021, përcaktohet se: *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”*, dhe pasi që kjo dispozitë ligjore nuk e detyron shprehimisht të paditurën për kompensimin e shujtës ditore ashtu siç ka kërkuar paditësi, gjykata vendosi si në pikën -III- të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe po ashtu duke u bazuar edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës është paraparë se: *“Në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e shujtës ditore për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, nuk aplikohet neni 29 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe neni 30 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021”*.

Pra, duke u bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme, rezulton se përfshirja e shpërblimit të shujtës ditore është e karakterit deklarativ dhe nuk përcaktojnë detyrime konkrete për punëdhënësin, por vetëm theksojnë se duhet të jenë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, gjithashtu nuk janë përcaktuar as kushtet, mënyra, lartësia dhe realizimi i shpërblimit të shujtës ditore.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara. E paditura nuk mund ta mënjanoj detyrimin me pretendimin se detyrimet financiare nga Udhëzimi Administrativ nuk prodhojnë efekt për shkak se nuk janë në harmoni me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, dhe lidhur me këtë, gjykata vlerëson se këto akte, në këtë rast Udhëzimet Administrative të lartcekura, janë aprovuar nga struktura të larta të të paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim edhe motivimin e punonjësve për punë kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtit. Për më tepër, derisa ato janë qartë të specifikuar, nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësit duke u thirrur në ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për tu përmbushur detyrimi që rezulton nga dispozitat e lartcekura përderisa e paditura me asnjë provë shkresore-analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç ka kërkuar paditës për pjesën e aprovuar të kërkesës.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore si në pikën -IV- të dispozitivit, gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 449, 452 par.3 dhe nenit 453 të LPK-së.

Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit i referohen shumës së precizuar si në pikën -IV- të dispozitivit të këtij aktgjykimit e cila përfshin shpenzimet nga pala paditëse dhe atë për përpilimin e padisë në shumën prej 104 euro, si dhe për taksën gjyqësore shumën prej 30 euro, e në shumë të përgjithshme prej 134 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe 152 të LPK-së.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.257/22, datë 22.03.2024

G j y q t a r i
Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Numri i lëndës: 2022:129499
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05488252